

Kombetarja/ Shqipëria mberrin ne Qipro, per vendin e katert

nga AlbaniaSoccer

E hënë, 14 Tetor 2013 14:18



Shqipëria ka mbërritur te dielën në Qipro dhe është akomoduar në një nga hotelet me të mira të Nikosias. Kuqëzinjtë nën urdhrat e De Biasit do të zhvillojnë përgatitjet e fundit para ndeshjes që do të luhet të martën. Teksa matematika na la jashtë çdo mundësie për të arritur një nga tre vendet e para në grupin E, kombëtarja Shqiptare luan në Qipro shansin e vet për të sulmuar vendin e 4. Ndaj skuadres me të dobët të grupit, djemte e De Biasit kanë një mision për të përmbushur edhe pse është shumë larg atij që në pretendonim një muaj më parë. Në garë për këto pozicione janë tre skuadra, Islanda, Sllovenia dhe Norvegjia. Duke qenë se nga Norvegjia e vendit të katërt na ndan një pikë, atëherë matematika na lejon të enderrojme për vendin e katërt në grup.